

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Scipio” SHPK

Ortaku themelues si më poshtë:

Z. Greg Xhillari, shtetas shqiptar, i biri i Albanit, i datëlindjes 16.01.1997, lindur dhe banues në Tiranë, rruga “Thanas Ziko”, mbajtës i letërnjoftimit me nr personal J70116061L,

bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 16.10.2025, harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “Scipio”.

Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare “Scipio”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “Scipio” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën rruga “Murat Toptani”, pranë kinema “Millennium”, ish-Pallati i Pioniereve, Zk. 8150, Tiranë Shqipëri.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në disa fusha si më poshtë:

- Në fushën e Ndertimit; Projektimit dhe të ndërtimit: kat. 1/e-plan vendosje objekte të veçanta, kat. 2/a, projekte dhe ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore, etj. mbi 5 kate dhe kompletim me instalimet e nevojshme për to;
Projekte dhe ndërtime civile industriale, turistike, bujqësore, etj. dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to;
Projektim pejsazhi (sistemime, lulishte, vepra arti, dekor, etj.);
Projektim interiere, mobilje, pajisje, dizajn industrial; punime dheu, sistemime, tarracime, prodhime elementësh të parafabrikuara betoni e betonarme dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to, ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore, etj. dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to, ndërtim rruge, kat. V, IV ndërtime rruge kat. III, II, I, ndërtim fusha aviacioni, veshje me asfaltobeton të rrugëve (ndërtim mbishtrësë) si dhe sistemim e asfaltim sheshe, ndërtim vepra arti rrugore e hekurudhore, ndërtime ujësjellëse e kanalizime, sillosa, kulla uji;
Pre-betonarmeje e metalike, punime karpentjerie metalike, shpime pusesh gjeologjike inxhinierike e hidro-gjeologjike, veshje fasadash. Rilevime topografike, punime topogjeodezike, punime në sipërfaqe të gjelbërta parqe, lulishte, instalimi i impianteve



- ngritëse dhe transportuese (ashensorë etj.), instalimi i impianteve të ngrohjes e ftohjes, instalimi i impianteve higjenike, instalimi i impianteve nënpresion, restaurim i ndërtesave monument kulture, punime restaurimi në vepra arkeologjike, ndërtime diga, galeri, tunele, punime mbrojtje të sistemit hidraulik-çimentime, kanale e impiante vaditje, punime karpentierë druri dhe metali, kabinat e transformatorëve;
- Në fushën e Pastrimit dhe higjenizimit me avull të brendshëm dhe të jashtëm të makinave dhe objekteve të ndryshme, pastrim me avull, higjenizim i tapicerise se makinave, dhe objekteve të ndryshme, riparim i lekures se makinave, shërbime automjetesh, ilustrim karrocierie, dritareve dhe xhamave, blerje-shitje e produkteve higjenizues, detergjente dhe materiale të ndryshme për pastrim me avull të makinave, blerje-shitje të makinave, krijim dhe zhvillim të rrjetit franchise në nivel kombëtar.
 - Në fushën e bare dhe restorante.
 - Menaxhim të bareve dhe restorante.
 - Në fushën e marketingut, organizimit të eventeve, konsulencë për evente, organizime festivalesh, ndërmjetësim me të tretët për organizime eventesh, reklamime on-line të produkteve apo eventeve etj.
 - Në fushën e turizmit sipërmarrjes turistike, nëpërmjet hapjes së hoteleve, fshatrave turistike, njësive të akomodimit të turistëve, bar-restorante turistike, si dhe t'u ofrojë turistëve dhe vizitorëve transport, guidë dhe aktivitete argëtuese me mjete motorike, lundruese, anije apo varka etj;
 - Shitjes së biletave të transportit ajror, tokësor, detar, aktivitete turistike brenda dhe jashtë vendit;
 - Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj edhe në import eksport – in e mjeteve apo materialeve që lidhen me kryerjen e objektit kryesor të saj.
 - Në fushën e shërbimit të reklames, publicitet, (billboard) për produkte të ndryshme, aktivitete tregtare, artistike, etj, si dhe çdo lloj shërbimi që ka lidhje me reklamen.
 - Në fushën e pasurive të paluajtshme shit-bletje të tyre;
 - Marrje dhe dhënie me qera të pasurive të paluajtshme;
 - Menaxhim si dhe ndërmjetësim për shitje - blerje apo dhënie me qera të pronave të paluajtshme midis personave fizikë dhe juridikë, privatë apo publikë, si dhe nga shteti në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar, si dhe çdo veprim tjetër i ligjshëm që ka të bëjë me pasuritë e paluajtshme.
 - Shoqëria mund të bashkëpunojë me shoqëri të tjera, vendase apo të huaja, për përmbushjen e objektit të aktivitetit të saj.

NENI 5 **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 6 **Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit**

Shoqëria tregtare "Scipio" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7 **Përgjegjësia e Ortakëve**

Ortaku/ët nuk përgjigjet/n për detyrimet e shoqërisë "Scipio" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8 **Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat**



8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Scipio" SHPK është 100,000 (njëqind mijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortakut i vetëm Greg Xhillari i cili zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit me vlerë 100,000 (njëqind mijë) lekë, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 100 % (njëqind përqind) në kapitalin e shoqërisë.

NENI 9 **Organet e Shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10 **Administratori**

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administrator i Shoqërisë do të jetë ortakut i vetëm Greg Xhillari.

NENI 11 **Sekreti tregtar**

Ortakut/ët, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë "Scipio" SHPK përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

NENI 12

Të gjitha mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 3 (tre) origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKU THEMELUES

GREG XHILLARI

